



Miratimi i udhëzimeve të reja për përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve në lëndët penale

Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it me rastin e Asamblesë së 13-të të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Prishtinë, më 27 janar 2011, dhe e përbërë nga Gjyqtarët në vijim:

Maria Giuliana Civinini, Charles Smith, Martti Harsia, Lars Dahlstedt, Gerrit-Marc Sprenger, Tapio Vanamo, Torsten Koschinka, Norbert Koster, Piero Leanza, Anna Bednarek, Esma etezi, Antoinette Lepeltier-Durel, Laura Plesa, Roxana Comsa, Katarina Entcheva, Francesco Florit, Arkadiusz Sedek, Ferdinando Buatier de Mongot, Karen Asphaug-Warg, Gianfranco Gallo, Horst Proetel, Johanna Schokkenbroek, Vergiinia Micheva-Ruseva, Dragomir Yordanov, Vitor Hugo Pardal, Rositzka Buzova, Gunnar Oyhaugen, Franciska Fiser, Riku Jaakkola, Witold Jakimko, Vladimir Kanev, Klaus Jung, Hajnalka Karpati, Nikolay Entchev, Caroline Charpentier, Christine Lindemann-Proetel, Jonathan Welford-Carrol

Me 28 vota për, asnjë kundër, 7 abstenime dhe 2 gjyqtarë nuk votuan

VENDOS

Që të aprovoj Udhëzime të reja për Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në lëndët penale.

Maria Giuliana Civinini

Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rr. Luan Haradinaj, Avenjja
e Policisë, Fahu postal: 268,
10000, Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu,
info@eulex-kosovo.eu

ANEKS: Udhëzimet e reja për Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në lëndë penale.



Udhëzime për Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët e Eulex-it në Lëndët Penale

1.1. Baza ligjore

Caktimi i lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it do të bëhet në përputhje me Ligjin mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-053), më tutje si LmK.

1.2. Parimet

- **Transparenca:** Caktimi i lëndëve duhet të jetë transparent për palët në sistemin e drejtësisë.
- **Objektiviteti:** Të gjithë duhet ta dinë paraprakisht ku dhe nga cili gjyqtarë ai/ajo do të gjykohet (gjyqtarët nuk i zgjedhin lëndët).
- **Fleksibiliteti:** Kushtet specifike të punës, numri i gjyqtarëve të EULEX-it dhe rregullat për përjashtim ligjor të përcaktuara me KPPPK duhet të merren parasysh.
- **Qëndrueshmëria:** Sistemi për caktimin e lëndëve duhet të jetë shembull i zbatimit të duhur të drejtësisë të cilin gjyqtarët vendorë do të mund (do të duhej) ta zbatojnë në mënyrë që t'i arrijnë qëllimet e një sistemi të pavarur, transparent dhe efikas të zbatimit të drejtësisë.
- **Ndarja e barabartë e punës së gjyqtarëve.**
- Gjyqtarët e EULEX-it vendosen në Gjykatën Supreme ose në një apo më shumë Gjykata të Qarkut. Vendosja e Gjyqtarëve të EULEX-it në më shumë se një Gjykatë të Qarkut do t'i përgjigjet domosdoshmërisë së zëvendësimit në raste të jashtëzakonshme, siç është përcaktuar në vijim nën 1.3.7.

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rr. Luan Haradinaj, Avenyja
e Policisë, Fahu postal: 268,
10000, Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu,
info@eulex-kosovo.eu

1.3 Caktimi i lëndëve gjatë fazës së procedurës paraprake (përfshirë fazën e konfirmimit) në Gjykatat e Qarkut në Prishtinë dhe Mitrovicë

- 1.3.1. Gjyqtarët penal të EULEX-it do të ndahen në dy nëngrupe brenda secilës Gjykatë të Qarkut.



- 1.3.2 Lëndët e reja do t'i caktohen në mënyrë alternative secilit nëngrup (p.sh. lënda A seksionit 1, lënda B seksionit 2, lënda C seksionit 1, etj).
- 1.3.3. Në kuadër të secilit nëngrup gjyqtari i procedurës paraprake do të caktohet në bazë të rotacionit. Nëse gjyqtari i cili duhet të caktohet sipas orarit përjashtohet (për arsye të përjashtimit ose arsye tjera serioze), lënda do t'i caktohet gjyqtarit të ardhshëm sipas orarit të brendshëm të seksionit. Gjyqtari i cili e ka kaluar rendin do të caktohet në lëndën e ardhshme.
- 1.3.4. Anëtarët tjerë të nëngrupit do ta formojnë kolegjin prej tre anëtarësh gjatë fazës së procedurës paraprake (p.sh. lënda n. 1 Gjyqtarit A si gjyqtar i procedurës paraprake dhe gjyqtarët B dhe C si anëtarë të kolegjit prej tre anëtarësh, lënda n. 2 Gjyqtarit B si gjyqtar i procedurës paraprake dhe gjyqtarët c dhe A si anëtarë të kolegjit prej tre anëtarësh, lënda n. 3 Gjyqtarit C si kryetar dhe gjyqtarit A si anëtar i kolegjit etj). Skema e tillë e rotacionit do të marr pëlqimin paraprak nga anëtarët e nëngrupit.
- 1.3.5. Anëtari i kolegjit i Kosovës do të caktohet nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut sipas sistemit të tyre për caktimin e lëndëve, pas kërkesës së Personit kontaktues të EULEX-it.
- 1.3.6. Nëse për çfarëdo arsye nuk mund të sigurohen gjyqtarët e nevojshëm nga mesi i anëtarëve të nëngrupit, ata do të caktohen nga Personi kontaktues i Ekipit të Gjykatës nga mesi i Gjyqtarëve të nëngrupeve të tjera sipas skemës automatike të rotacionit, përveç nëse kjo e privon seksionin në fjalë nga numri i mjaftueshëm i gjyqtarëve për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor. Në rastin e fundit, anëtari i kolegjit do të caktohet sipas rregullave e përcaktuara në vijim nën 1.3.7.
- 1.3.7. Në rast se asnjë Gjyqtar i Ekipit të Gjykatës (përfshirë Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, Gjyqtarët civil) nuk janë në gjendje të marrin pjesë në kolegji sipas rregullave të përcaktuara në lart, një Gjyqtar nga një Gjykatë e Qarkut tjetër do të caktohet nga Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, pas kërkesës së Personit kontaktues të Ekipit të Gjykatës, sipas skemës në vijim:
- Gjyqtarët të cilët së pari janë caktuar në GjQ në Mitrovicë do të caktohen si zëvendësues në GjQ në Prishtinë.
 - Gjyqtarët të cilët së pari janë caktuar në GjQ në Prishtinë do të caktohen si zëvendësues në GjQ në Gjilan.
 - Gjyqtarët të cilët së pari janë caktuar në GjQ në Gjilan do të caktohen si zëvendësues në GjQ në Mitrovicë.

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rr. Luan Haradinaj, Avenjja
e Policisë, Fahu postal: 268,
10000, Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu,
info@eulex-kosovo.eu



- Gjyqtarët të cilët së pari janë caktuar në GjQ në Prizren do të caktohen si zëvendësues në GjQ në Pejë.
- Gjyqtarët të cilët së pari janë caktuar në GjQ në Pejë do të caktohen si zëvendësues në GjQ në Prizren.

1.3.8. Gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës dhe për ankesë kundër aktvendimit mbi konfirmimin e aktakuzës do të caktohet nga mesi i Gjyqtarëve të nëngrupit përgjegjës për fazën e hetimeve. Nëse kjo nuk është e mundur, për shkak të përjashtimit apo arsyeve të tjera serioze, do të caktohet një gjyqtarë nga një nëngrup tjetër. Në rast se kjo shpie në një numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve në dispozicion për shqyrtim gjyqësor, do të caktohen gjyqtari (gjyqtarët) nga një Gjykatë tjetër e Qarkut.

Emërimi do të bëhet në bazë të rregullave të përcaktuara si më lart në pikën 1.3.7.

1.4 Caktimi i lëndëve gjatë fazës së procedurës paraprake (duke përfshirë këtu edhe fazën e konfirmimit të aktakuzës) në Gjykatat e Qarkut të Pejës, të Prizrenit dhe të Gjilanit

1.4.1 Me qëllim të shmangies së përjashtimit të gjyqtarëve gjatë fazës së mëvonshme të procedurës, gjyqtarët e EULEX-it kryesisht do të caktohen në shqyrtime gjyqësore.

1.4.2 Kur ka nevojë që në procedurën paraprake të caktohen gjyqtarët e EULEX-it apo për konfirmimin e aktakuzës ose për të zëvendësuar një gjyqtar me arsye të bazuara, do të emërohet gjyqtari penal nga radhët e atyre gjyqtarëve të caktuar në secilën gjykatë. Në rast se kjo gjë shpie tek një numër i pamjaftueshëm i gjyqtarëve të EULEX-it për shqyrtimin gjyqësor, atëherë një gjyqtar tjetër apo një gjyqtar civil i EULEX-it nga një gjykatë tjetër e qarkut mund të caktohet në procedurën paraprake nga ana e Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it.

1.4.3 Zëvendësimi i gjyqtarëve të gjykatave do të bëhet sipas rregullave të përcaktuara më lart në pikën 1.3.7.

1.5 Caktimi i lëndëve për gjykatat e qarkut të Prishtinës dhe të Mitrovicës: Shqyrtimi gjyqësor

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rr. Luan Haradinaj, Avenjja
e Policisë, Fahu postal: 268,
10000, Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu,
info@eulex-kosovo.eu



- 1.5.1 Gjyqtarët penalë të EULEX-it janë të ndarë në dy nëngrupe brenda secilës gjykatë të qarkut, në bazë të rregullave të përcaktuara në pikën 1.3.1.
- 1.5.2 Shqyrtimet e ardhshme gjyqësore do t'i caktohen atij nëngrupi i cili nuk ka qenë përgjegjës për procedurën paraprake (p.sh. nëse lënda A i është dhënë nëngrupit 1 gjatë procedurës paraprake, në fazën e shqyrtimit gjyqësor do t'i caktohet nëngrupit 2).
- 1.5.3 Brenda secilit nëngrup, Kryetari i kolegjit do të emërohet në bazë të rrotacionit. Anëtari tjetër i kolegjit nga EULEX-i do të emërohet në bazë të rrotacionit nga radhët e anëtarëve të tjerë të nëngrupit (p.sh. lënda 1 gjyqtarit A si kryetar ndërsa gjyqtarit B si anëtar, lënda 2 gjyqtarit B si kryetar ndërsa gjyqtarit C si anëtar, lënda 3 gjyqtarit C si kryetar ndërsa gjyqtarit A si anëtar e kështu me radhë). Një skemë e këtillë rrotulluese do të aprovohet paraprakisht nga radhët e vetë anëtarëve të grupit.
- 1.5.4 Anëtari kosovar i kolegjit do të emërohet nga kryetari përkatës i gjykatës së qarkut në bazë të sistemit të tyre për ndarjen e lëndëve, me kërkesë të personit kontaktues të EULEX-it;
- 1.5.5 Nëse gjyqtari i cili duhet të emërohet sipas orarit lihet jashtë (për shkak të përjashtimit apo të ndonjë arsye tjetër serioze), lënda do t'i caktohet gjyqtarit vijues sipas orarit të brendshëm të nëngrupit. Gjyqtari, të cilit i ka humbur radha, do të emërohet në rastin e parë që paraqitet.
- 1.5.6 Në rast se asnjë gjyqtar i nëngrupit nuk mund të bëhet pjesë e kolegjit, një apo më shumë gjyqtarë të nëngrupit tjetër do të emërohen nga personi kontaktues i ekipit të gjykatës. Do të zbatohet skema automatike rrotulluese me qëllim të emërimit të gjyqtarëve zëvendësues.
- 1.5.7 Në rast se asnjë gjyqtar nuk ka të drejtë të merr pjesë në kolegji, atëherë Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it do ta emërojë një gjyqtar nga një Gjykatë tjetër e Qarkut, me kërkesë të personit kontaktues të ekipit të gjykatës. Zëvendësimi i gjyqtarëve të gjykatave bëhet sipas skemës së përcaktuar me pikën 1.3.7,

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rr. Luan Haradinaj, Avenyja
e Policisë, Fahu postal: 268,
10000, Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu,
info@eulex-kosovo.eu



1.5.8 Gjyqtari i cili emërohet si kryetar i kolegjit është përgjegjës për përgatitjen e duhur të lëndës si dhe për hartimin e aktgjykimit dhe të aktvendimeve të tjera në këtë lëndë;

1.6 Caktimi i lëndëve për gjykatat e qarkut të Gjilanit, të Pejës dhe të Prizrenit: Shqyrtimi gjyqësor

1.6.1. Gjykata do të organizohet në një nëngrup të vetëm, i cili do të përbëhet nga të gjithë gjyqtarët penalë të ekipit

1.6.2. Për secilën lëndë të ardhshme, kryetari i kolegjit dhe anëtari tjetër i EULEX-it do të emërohen në bazë të rrotacionit nga radhët e anëtarëve të tjerë të nëngrupit (p.sh. lënda 1 gjyqtarit A si kryetar ndërsa gjyqtarit B si anëtar, lënda 2 gjyqtarit B si kryetar ndërsa gjyqtarit C si anëtar, lënda 3 gjyqtarit C si kryetar ndërsa gjyqtarit A si anëtar e kështu me radhë). Një skemë e këtillë rrotulluese do të aprovohet paraprakisht nga radhët e vetë anëtarëve të grupit.

1.6.3. Anëtari kosovar i kolegjit do të emërohet nga kryetari përkatës i gjykatës së qarkut në bazë të sistemit të tyre për ndarjen e lëndëve, me kërkesë të personit kontaktues të EULEX-it;

1.6.4. Nëse gjyqtari i cili duhet të emërohet sipas orarit lihet jashtë (për shkak të përjashtimit apo të ndonjë arsye tjetër serioze), lënda do t'i caktohet gjyqtarit vijues sipas orarit të brendshëm të nëngrupit. Gjyqtari, të cilit i ka humbur radha, do të emërohet në rastin e parë që paraqitet.

1.6.5. Në rast se asnjë gjyqtar nuk ka të drejtë të merr pjesë në kolegji, atëherë Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it do ta emërojë një gjyqtar nga një Gjykatë tjetër e Qarkut, me kërkesë të personit kontaktues të ekipit të gjykatës. Zëvendësimi i gjyqtarëve të gjykatave bëhet sipas skemës së përcaktuar me pikën 1.3.7,

1.6.6. Gjyqtari i cili emërohet si kryetar i kolegjit është përgjegjës për përgatitjen e duhur të lëndës si dhe për hartimin e aktgjykimit dhe të aktvendimeve të tjera në këtë lëndë.

EULEX Kosovë

**Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it**
Gjykata Supreme e Kosovës
Rr. Luan Haradinaj, Avenyja
e Policisë, Fahu postal: 268,
10000, Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu,
info@eulex-kosovo.eu



2. Personi kontaktues i ekipit të gjykatës është përgjegjës për zbatimin e duhur të këtyre udhëzimeve, duke pasur parasysh po ashtu edhe parimet e përgjithshme të përcaktuara më lart.

3. Sistemi i kujdestarisë

Sistemi i kujdestarisë do të zbatohet për raste urgjente në mes të gjykatave me qëllim të sigurimit të numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve për çështje urgjente. Në rast se ka nevojë të aplikojë një gjyqtar nga gjykata tjetër e qarkut, do të zbatohet skema e përcaktuar me pikën 1.3.7.

Afati kohor i kujdestarisë është një javë për një herë, duke përfshirë këtu edhe fundjavën. Propozimi i sistemit rrotullues do të përcillet nga personat kontaktues tek Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it jo më herët sesa një muaj përpara.

4. Rrethanat e jashtëzakonshme

Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, për arsye të bazuara, mund t'iu shmanget Rregullave të përmendura më lart në raste të jashtëzakonshme (p.sh. çekuilibrim shumë serioz i ndarjes së punës, nevoja për të pasur një koleg të përbërë vetëm prej gjyqtarëve të EULEX-it në bazë të dispozitave përkatëse të Ligjit mbi kompetencat, dhe për arsye të tjera të rëndësishme)

5. **Aktivitetet e MUK-ut të Gjyqtarëve të EULEX-it** do të ndjekin udhëzimet e veçanta të përcaktuara nga Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it.

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it
Gjykata Supreme e Kosovës
Rr. Luan Haradinaj, Avenyja
e Policisë, Fahu postal: 268,
10000, Prishtinë, Kosovë
www.eulex-kosovo.eu,
info@eulex-kosovo.eu